L I G J
Nr.8076, datë 22.2.1996

PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Banka e Shqipërisë është person juridik i pavarur me qendër në Tiranë.

Banka e Shqipërisë gëzon të drejtën:

a) Të lidhë kontrata dhe të emetojë obligacione.

b) Të nxjerrë akte nënligjore.

c) Të blejë, të ketë e të përdorë dhe të zotërojë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së saj.

Neni 2

Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë.

Jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në intervale 6-mujore pas kësaj, Banka e Shqipërisë i dorëzon Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave një deklaratë për politikën monetare, të cilën e boton. Në këtë deklaratë përmbahen:

a) vlerësimi i politikës monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë për periudhën e mëparshme:

b) politika monetare që do të ndiqet nga Banka e Shqipërisë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm;

c) parimet për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare për një periudhë që e cakton Banka e Shqipërisë.

Neni 3

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të sigurojë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve.

Në përputhje me objektin e saj kryesor, Banka e Shqipërisë nxit e mbështet zhvillimin mbi bazën e tregut, të sistemit të këmbimeve valutore, të tregut të brendshëm financiar dhe të sistemit të pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese në mbështetje të stabilitetit dhe zhvillimet ekonomike të vendit.

Çdo objektiv dhe detyrë tjetër që i caktohet Bankës së Shqipërisë e që buron nga kompetencat dhe përgjegjësitë e saj, sipas nenit 13, kushtëzohet me arritjen e objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4

Bankës së Shqipërisë i jepet për mendim çdo akt normativ që i dërgohet për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave, në fushën e politikës financiare, monetare dhe valutore.

Neni 5

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë pjesë, të bashkëpunojë e të nënshkruajë marrëveshje bankare me institucionet financiare ndërkombëtare dhe me institucionet financiare publike dhe private në vendet e tjera.

Neni 6

Banka e Shqipërisë jep licencë për krijimin e bankave dhe të institucioneve financiare që kryejnë veprimtari bankare si dhe mbikëqyr e rregullon veprimtarinë e tyre.

KREU II
FONDET THEMELORE DHE CAKTIMI I FITIMIT

Neni 7

Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 750 milionë lekë.

Fondi i themelimit mund të rritet me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave.

I tërë fondi i themelimit akordohet dhe është në pronësi ekskluzive të shtetit. Ky fond nuk mund të transferohet ose hipotekohet.

Neni 8

Kur në bilancin e Bankës së Shqipërisë vlera e mjeteve të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe fondit të themelimit, ministri i Financave për të mbuluar mungesën e mjeteve transferon në Bankën e Shqipërisë letra me vlerë shtetërore të tregtueshme, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut.

Neni 9

Fitimi neto i Bankës së Shqipërisë për çdo vit financiar llogaritet pasi të zbriten nga të ardhurat shpenzimet e bëra për vitin financiar në fjalë, pasi zbatohet metodologjia e caktuar për vlerësimin e mjeteve dhe burimeve të bilancit të Bankës së Shqipërisë, dhe pas veçimeve për:

a) borxhe të dyshimta e pa shpresë arkëtimi dhe masa e zhvlerësimit të mjeteve në bilancin e Bankës së Shqipërisë;

b) shpenzime për subjekte të miratuara nga Këshilli i Ministrave për qëllime të tjera të këtij lloji, kur Banka e Shqipërisë e quan të nevojshme;

c) humbjet që rrjedhin nga vlerësimi i valutës në aktiv, nëse balanca e llogarisë “Rezervë për vlerësimin e valutës” nuk është e mjaftueshme për të mbuluar këtë vlerësim.

Në bilancin dhe në raportin financiar të Bankës së Shqipërisë duhet të përfshihen llogari të veçanta për provigjonet për borxhet e dyshimta e pa shpresë arkëtimi, për zhvleftësimin e mjeteve të bilancit dhe llogaria e rezervës së përgjithshme.

Neni 10

Banka e Shqipërisë krijon një fond të rezervës së përgjithshme. Në fund të çdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25 për qind të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë, derisa fondi i rezervës së përgjithshme të arrijë në 500 për qind të fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11

Pas kalimit në fondin e rezervës së përgjithshme sipas nenit 10, mbetja e fitimit neto për vitin financiar do të përdoret për të kompensuar letrat me vlerë që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

Fitimi neto për vitin financiar, që mbetet pasi bëhen zbritje sipas neneve 9, 10 dhe paragrafit të

parë të nenit 11 të këtij ligji, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda katër muajsh pas mbarimit të vitit financiar.

Neni 12

Kur mjetet e Bankës së Shqipërisë do të jenë më pak se shuma e detyrimeve të saj dhe e fondit të themelimit, nuk do të bëhet asnjë transferim, shlyerje ose pagesë sipas neneve 9, 10 e 11 të këtij ligji.

KREU III
VEPRIMTARITË KRYESORE TË BANKËS

Neni 13

Banka e Shqipërisë ka kompetenca dhe mban përgjegjësi për veprimtaritë e mëposhtme:

a) të hartojë dhe të zbatojë politikën monetare dhe politikën e tregut valutor;

b) të veprojë me cilësinë e bankierit e të këshilltarit, si dhe të agjentit fiskal për shtetin;

c) të veprojë si emetues i vetëm i monedhës dhe kartëmonedhës kombëtare në Republikën e Shqipërisë;

d) të përgatitë analiza të rregullta ekonomike e monetare, të publikojë rezultatet dhe t'i paraqesë propozime e masa qeverisë mbi bazën e këtyre analizave;

e) të licencojë, të mbikëqyrë e të rregullojë veprimtarinë e bankave dhe veprimtarinë bankare të institucioneve financiare;

f) t'u japë kredi bankave;

g) të mbikëqyrë sistemet e pagesave në Republikën e Shqipërisë dhe të lehtësojë kryerjen e pagesave e të likuidimeve efektive ndërmjet bankave;

h) të tregtojë letra me vlerë;

i) të mbajë dhe administrojë rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë;

j) të ndërmarrë në emër të Republikës së Shqipërisë detyrime dhe të kryejë veprime bankare që burojnë nga pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në institucionet publike ndërkombëtare në fushën bankare, monetare dhe të kreditit;

k) t'i japë kredi shtetit;

l) të veprojë si bankiere me institucionet financiare, qeveritë e huaja dhe agjencitë ndërkombëtare;

n) të shpërndajë letra me vlerë për llogari të shtetit dhe të emetojë letra me vlerë për llogari të vet.

Neni 14

1. Banka e Shqipërisë ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë ligj, ose nga ligje të tjera, si dhe të drejta të tjera që lidhen me ushtrimin e kompetencave që asaj i janë dhënë.

2. Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, Banka e Shqipërisë:

a) nuk jep ndihmë financiare në formë huaje të drejtpërdrejtë ose donacioni, nuk jep hua të kushtëzuar, nuk blen hua, nuk merr pjesë si kreditore solidare ose në instrumentet e tjera të detyrimeve, si dhe nuk subvencionon borxhet ose detyrimet e kushtëzuara të shfarëdolloj forme që të jenë;

b) nuk merret me veprimtari tregtare, nuk blen aksione të shoqërive tregtare ose të subjekteve të ndryshme, duke përfshirë edhe aksionet e institucioneve financiare ose të jetë bashkëpronare në ndonjë veprimtari financiare, tregtare, bujqësore, industriale ose veprimtari tjetër, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në pikën 3 të këtij neni;

c) nuk fiton nëpërmjet blerjes, ose në një formë tjetër të drejta reale, për pasuri të paluajtshme, me përjashtim të rasteve kur ajo e gjykon të nevojshme ose të përshtatshme për sigurimin e administrimit dhe anës operacionale, si dhe për banesa të punonjësve të saj, ose për kërkesa të tjera të ngjashme, në zbatim të funksioneve që i njeh ky ligj.

3. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 1 dhe 2, Bankës së Shqipërisë i lejohet:

a) Të bëjë investime në kapital në shuma totale, jo më shumë 5 për qind të kapitaleve dhe rezervave të saj, në subjektet që kanë si objekt vetëm veprimtari shërbimi për Bankën e Shqipërisë dhe në institucionet financiare që kanë si objekt vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e kolateraleve, të përpunimit dhe transmetimit të të dhënave, të shtypit financiar, të kleringut, të pagesave, të shërbimeve korriere dhe të likuidimit të pronës.

b) Të krijojë fondet e pensionit për personelin, ose të bëjë marrëveshje të ngjashme në përfitim a në mbrojtje të nëpunësve, punonjësve dhe kandidatëve të saj, si dhe të kontribuojë në koston ekuivalente të këtyre marrëveshjeve.

c) T'i japë kredi çdo punonjësi të saj për përmirësimin e kushteve të jetesës në shumat dhe kriteret e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 15

Banka e Shqipërisë mund të regjistrojë dhe evidentojë borxhin e jashtëm publik dhe privat të Republikës së Shqipërisë, nëse e sheh të nevojshme a të mundshme ta kryejë këtë funksion, dhe në marrëveshje me Ministrinë e Financave.

KREU IV
MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKAVE TË TJERA NË SHQIPËRI

Neni 16

Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare që veprojnë si bankë në Republikën e Shqipërisë. Për këtë Banka e Shqipërisë:

a) Nxjerr rregullore, urdhra e udhëzime dhe jep udhëzime metodike për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar në bazë dhe për zbatim të ligjit.

b) Kontrollon çdo zyrë, llogari dhe dokumente të bankave, si dhe të subjekteve të tjerë që kryejnë veprimtari bankare me licencë. Ajo merr informacionet që i gjykon të nevojshme.

Neni 17

Banka e Shqipërisë mbikëqyr pagesat ndërkombëtare që rrjedhin nga tregtia e jashtme, veprimet jotregtare dhe angazhimet e bankave të tjera shqiptare dhe institucioneve financiare që kryejnë veprimtari bankare dhe që kanë lidhur kontrata me shtete, banka a shoqëri të huaja.

Neni 18

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të hapë në regjistrat e saj llogari nga bankat që kanë licencë dhe të pranojë prej tyre depozita, me afat dhe kushte që përcaktohen prej saj.

Neni 19

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 13, shkronja "h", veprimet e skontimit dhe të riskontimit nga Banka e Shqipërisë janë të vlefshme vetëm për bankat dhe institucionet financiare që ushtrojnë veprimtari bankare dhe që mbajnë llogari në regjistrat e Bankës së Shqipërisë si dhe për letrat me vlerë të mëposhtme:

a) Kambiale dhe tituj pagese të tërhequra ose të bëra për qëllime tregtare, industriale a bujqësore, që mbajnë dy ose më shumë nënshkrime të rregullta, nga të cilat, së paku njëri prej tyre, duhet të jetë i një banke me licencë të depozituar. Kambialet bëhen të vlefshme brenda 182 ditësh nga data e blerjes së tyre në Bankën e Shqipërisë.

b) Letrat me vlerë të emetuara nga organe shtetërore të caktuara dhe letrat e tjera me vlerë të nxjerra publikisht ose të garantuara nga shteti, që formojnë pjesë të një emetimi publik dhe që maturohen brenda një viti nga data e paraqitjes së tyre te Banka e Shqipërisë.

c) Letra me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

2. Veprimet e skontimit e të riskontimit të Bankës së Shqipërisë i nënshtrohen afateve dhe kushteve të tjera që përcaktohen në rregullore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 20

Banka e Shqipërisë u jep bankave që kanë llogari në regjistrat e saj, kredi me afate dhe kushte që përcakton prej saj, por jo më tepër se 92 ditë si vijon:

1. Kredi që janë të garantuara nga:

a) instrumentet e specifikuara në pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji;

b) depozita në Bankën e Shqipërisë ose një depozitë e pranueshme nga Banka e Shqipërisë për çdo pasuri që ajo lejohet të blejë, shesë a trajtojë sipas këtij ligji.

Dhënia e kredisë së parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni mund të trajtohet si hua me afate fikse dhe si marrëveshje riblerjeje. Llogaritë e zbuluara nuk do të lejohen.

2. Për bankat nën kujdestari, sipas ligjit nr.8075, datë 22.2.1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë" mund të japë kredi që janë të pagarantuara, ose që mund të garantohen me mjete të tjera, në kushte dhe në afatet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, por vetëm në rastet kur, sipas gjykimit të kësaj të fundit, dhënia e kredisë është e nevojshme në rastet e veçanta, me qëllim që të ruajë integritetin e sistemit bankar.

Neni 21

Kredia nga Banka e Shqipërisë për bankat e tjera u jepet vetëm drejtorive të përgjithshme të tyre në Shqipëri.

Neni 22

Afatet dhe përqindjet që zbatohen nga Banka e Shqipërisë për skontime, riskontime dhe kredi, si dhe përqindjet e diferencuara dhe nivelet maksimale për kategori të ndryshme veprimesh bankare, caktohen nga Banka e Shqipërisë dhe shpallen në buletinin e saj.

Neni 23

1. Banka e Shqipërisë kërkon nga bankat të mbajnë depozitat pranë saj në nivele minimale të përcaktuara (rezerva të detyrueshme) që lidhen me madhësinë e fondeve ose me kategoritë specifike të pasivit.

2. Rezervat e detyrueshme mbahen si depozitë monetare në Bankën e Shqipërisë në raporte të tilla që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë, me kusht që bankat të mos mbajnë rezerva të detyrueshme në Bankën e Shqipërisë më shumë se 20 për qind të shumës së përgjithshme të depozitave monetare të çdo banke ose të pasivit të saj.

3. Banka e Shqipërisë mund të paguajë interes për rezervat e detyrueshme, i cili nuk mund të jetë më i madh se përqindja minimale e skontos së Bankës së Shqipërisë, zbatuar në periudhën përkatëse.

Neni 24

1. Kur bankat nuk mbajnë rezervat e detyruara të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë vendos një gjobë deri në plotësimin e rezervës së detyruar. Masa e gjobës nuk duhet ta kalojë dy herë përqindjen aktuale të skontos së Bankës së Shqipërisë.

2. Rregullat për rritjen e niveleve të rezervave të detyrueshme përcaktojnë edhe datën kur bankat duhet të arrijnë nivelet e reja të rezervës.

Neni 25

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat e tjera, mund të caktojë rregulla për kryerjen e

pagesave me çek ose instrumente të tjera që përdoren si mjete pagese, si dhe për shërbimet mbi transfertat telegrafike, mbi kleringun e letrave me vlerë dhe shërbimet në pagesa.

Neni 26

Banka e Shqipërisë krijon dhe mban rrjet informacioni për sistemin bankar.

Neni 27

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me cilindo autoritet të huaj për mbikëqyrjen bankare, mbi bazën e reciprocitetit, për të mbikëqyrur dhe inspektuar bankat që veprojnë drejtpërsëdrejti në juridiksionet e tyre përkatëse.

2. Banka e Shqipërisë shkëmben me autoritetet mbikëqyrëse bankare të huaja informacione për çdo bankë që vepron në juridiksionin e tyre përkatës, me kusht që autoritetet të marrin përsipër besueshmërinë e informacionit të marrë.

KREU V
MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS DHE SHTETIT

Neni 28

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet legjislative dhe ekzekutive të Republikës së Shqipërisë për të arritur objektivat e saj dhe, në bazë të ligjit, kur e konsideron të nevojshme ndërmerr veprime për të nxitur këtë bashkëpunim në realizimin e funksioneve të saj. Për formulimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore, banka e Shqipërisë këshillohet me ministrin e Financave, ose me organizma të tjerë qeveritarë, që ajo i shikon të përshtatshëm.

2. Banka e Shqipërisë jep kohë pas kohe informacionin e kërkuar nga ministritë dhe njësitë e tjera të qeverisë në lidhje me çështjet monetare e financiare dhe, anasjelltas, këto njësi japin kohë pas kohe informacionin e kërkuar nga Banka e Shqipërisë në lidhje me çështjet makroekonomike, monetare dhe financiare.

3. Banka e Shqipërisë përcakton nëpërmjet rregullave informacionin që kërkohet dhe mënyrën e dhënies së këtij informacioni për Bankën e Shqipërisë, personat e ngarkuar për ta dhënë këtë informacion dhe sekretin zyrtar që zbatohet për dhënien e informacionit.

Neni 29

1. Banka e Shqipërisë përfaqëson shtetin shqiptar në të gjitha marrëdhëniet dhe veprimtaritë bankare me shtetet, bankat dhe institucionet e huaja.

2. Banka e Shqipërisë mund, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikaura në marrëveshje me ministrin e Financave, të veprojë si agjente fiskale për llogari të Republikës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit bankar, kryen funksionet e arkës së buxhetit të shtetit.

Neni 30

1. Banka e Shqipërisë pranon depozita nga shteti dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave. Për këto depozita zbatohen interesa në përqindje, sipas marrëveshjes ndërmjet palëve, por jo më të larta se interesat e tregut për depozitat afatshkurtër.

2. Banka e Shqipërisë mund të autorizojë ndonjë institucion tjetër financiar t'i marrë këto depozita, në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje ndërmjet këtyre institucioneve dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 31

Banka e Shqipërisë mund të bjerë dakord me shtetin që të veprojë si agjente për këto veprime:

a) tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga shteti;

b) pagesën e vleftës, të interesit dhe të shpenzimeve të tjera për letrat me vlerë të parashikuara në pikën "a";

c) kryerjen e veprimeve me para lidhur me llogaritë e shtetit në Bankën e Shqipërisë.

Neni 32

1. Banka e Shqipërisë mund t'i japë kredi shtetit, të përfaqësuar vetëm nga Ministria e Financave nëpërmjet:

a) Blerjes së letrave me vlerë të qeverisë drejtpërsëdrejti prej Ministrisë së Financave, me maturim maksimumi deri në një vit dhe përqindje interesi jo më të vogël se i interesit të tregut aktual të bonove të thesarit, me të njëjtin maturim.

b) Blerjes së bonove të thesarit në ankand, ose

c) Blerjes së letrave me vlerë të qeverisë në tregun sekondar të letrave me vlerë.

2. Asnjëherë shuma totale e letrave me vlerë të qeverisë të blera nga Banka e Shqipërisë në çdo vit kalendarik:

a) sipas pikës 1/a të këtij neni nuk duhet të kalojë përqindjen ekuivalente të përcaktuara në pikën 3/a të këtij neni.

b) sipas pikës 1/b të këtij neni nuk duhet të kalojë përqindjen ekuivalente të përcaktuar sipas pikës 3/b të këtij neni të të ardhurave të zakonshme të buxhetit të shtetit të vitit të mëparshëm financiar të llogaritur menjëherë, me kusht që, në kuptim të këtij neni, "të ardhurat e zakonshme" nuk do të përfshijnë huatë, donacionet dhe forma të tjera të ndihmës financiare, si dhe shitjen e mjeteve të aktivit.

3. Kufijtë e financimit për vitet 1996, 1997 dhe 1998 do të jenë:

a) sipas paragrafit 2/a, përkatësisht 10 për qind, 6 për qind dhe 2 për qind dhe

b) sipas paragrafit 2/b të këtij neni përkatësisht nga 4 për qind të të ardhurave vjetore financiare të zakonshme të llogaritura menjëherë; me kushte që "të ardhurat e zakonshme" nuk përfshijnë huatë, donacionet dhe format e tjera të ndihmës financiare dhe shitjes së mjeteve të aktivit.

4. Nëse sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë dhënia e kredisë për qeverinë mund të kalojë kufijtë e kredisë së parashikuar në këtë nen për çdo vit kalendarik, Banka e Shqipërisë do të ndërpresë të japë çdo kredi të tillë për atë vit kalendarik.

5. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, Banka e Shqipërisë mundet që, me kërkesën e Ministrisë së Financave, të ristrukturojë letrat me vlerë të qeverisë që mban në portofolin e saj, në kohën e maturimit të tyre.

Neni 33

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 32, Banka e Shqipërisë mund t'i japë shtetit kredi, me afate dhe kushte sipas marrëveshjes ndërmjet palëve, mbi kufirin e caktuar për pagesat që rrjedhin nga anëtarësia e shtetit në një organizatë ndërkombëtare. Çdo dhënie kredie sipas këtij neni do të kushtëzohet nga emetimi i letrave me vlerë të qeverisë për Bankën e Shqipërisë, sipas kushteve dhe mënyrave të parashikuara me marrëveshje të përbashkët.

Neni 34

Banka e Shqipërisë mund të blejë e të shesë letra me vlerë të qeverisë, me maturim deri në një vit, që më parë kanë qënë publikisht të emetuara në lidhje me dhënien e kredive për bankat, sipas neneve 18 dhe 19 të këtij ligji.

KREU VI
EMETIMI I MONEDHËS

Neni 35

1. Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është "Lek-u".

2. Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të emetojë kartëmonedhën dhe monedhën që ka kursi ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Banka e Shqipërisë përcakton format, masat, peshat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave e monedhave metalike shqiptare, të cilat kanë kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartëmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike.

Neni 36

Sasia dhe procedurat për eksport-importet e kartëmonedhave e të monedhave metalike përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 37

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë dhe që nuk janë tërhequr nga qarkullimi, do të kenë kurs ligjor dhe do të pranohen për të gjitha pagesat e detyrimeve publike e private pa kufizim, me vlerën e tyre nominale.

Neni 38

Banka e Shqipërisë administron rezervën monetare ndërkombëtare, harton planet e emetimit dhe siguron furnizimin e rregullt me kartëmonedha dhe monedha metalike, për të plotësuar kërkesat e ekonomisë për para.

Neni 39

Vlefta e kartëmonedhave dhe monedhave metalike në qarkullim futen në llogarinë e Bankës së Shqipërisë si detyrime. Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të rezervës monetare nuk përfshihen në këtë detyrim.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të emetojë kartëmonedhë dhe monedhë mbi nivelin e rezervës ndërkombëtare në përputhje me nenin 38 të këtij ligji, duke e mbuluar plotësisht nga pasuritë e mëposhtme:

a) kreditë që Banka e Shqipërisë i jep shtetit dhe kreditë e dhëna nga Banka e Shqipërisë që garantohen nga shteti;

b) letrat me vlerë që mbahen në portofolin e investimeve nga Banka e Shqipërisë;

c) mjetet që rrjedhin nga kreditë që Banka e Shqipërisë u jep bankave;

d) çeqet, kambialet dhe instrumentet e borxheve që Banka e Shqipërisë i ka skontuar ose i mban në ruajtje.

Neni 40

Banka e Shqipërisë bën shtypjen e kartëmonedhave dhe prerjen e monedhave metalike, siguron dhe mban në vende të sigurta kartëmonedhat dhe monedhat metalike të paemetuara dhe ruan e asgjëson, kur është e nevojshme, pllakat dhe stampat e monedhave metalike e të kartëmonedhave që hiqen nga qarkullimi.

Banka e Shqipërisë shkëmben pa shpenzime e komisione kartëmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara prej saj.

Neni 41

Banka e Shqipërisë sekuestron dhe konfiskon kartëmonedhat dhe monedhat metalike false.

Kartëmonedhat dhe monedhat e pavlefshme tërhiqen, asgjësohen dhe zëvendësohen me kartëmonedha e monedha metalike nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë mund të refuzojë të shkëmbejë kartëmonedha ose monedha metalike, po qe se pamjet e tyre janë të palejushme, jo në formë të mirë, të shpuara ose nëse më shumë se 40 për qind e sipërfaqes së tyre ka humbur. Monedha të tilla tërhiqen dhe asgjësohen pa shpërblyer posedusin

me përjashtim të rasteve të veçanta, kur Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë një kompensim të plotë a të pjesshëm.

Bankës së Shqipërisë nuk i kërkohet të japë kompensim për kartëmonedhat dhe monedhat metalike që kanë humbur a janë dëmtuar. Ajo mund të konfiskojë pa kompensim çdo kartëmonedhë që mund të jetë ndryshuar në pamjen e jashtme, sidomos kartëmonedhat, mbi të cilat është shkruar, vizatuar, shtypur, stampuar apo janë bërë vrima, ose mbi të cilën është vënë material ngjitës.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë të mbledhë dhe të tërheqë nga qarkullimi çdo kartëmonedhë a monedhë metalike që ka emetuar, kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, duke emetuar në shkëmbim të tyre kartëmonedha dhe monedha metalike të tjera; në vendim specifikohet periudha, gjatë së cilës kartëmonedhat dhe monedhat metalike duhet të paraqiten. Një periudhë e tillë për ndërrime nuk duhet të jetë më pak se një vit nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare.

Në fund të kësaj periudhe:

a) kartëmonedhat dhe monedhat metalike të mbledhura për t'u ndërruar nuk do të jenë me para në qarkullim, pavarësisht nga neni 37;

b) kartëmonedhat ose monedhat metalike që janë mbledhur, por që janë paraqitur për t'u këmbyer, duhet të hiqen nga sasia e monedhës në qarkullim në regjistrat e Bankës së Shqipërisë dhe të konsiderohen si të ardhura të Bankës së Shqipërisë.

KREU VII
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I BANKËS

A. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Neni 42

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga shtatë anëtarë:
- Governatori i Bankës së Shqipërisë, kryetar i këshillit;
- zëvendësgovernatori i parë, zëvendëskryetar i këshillit;
- zëvendësgovernatori;
- katër anëtarë.

2. a) Governatori i Bankës së Shqipërisë propozohet nga këshilli mbikëqyrës dhe emërohet nga Presidenti i Republikës.

b) Zëvendësgovernatori i parë i Bankës së Shqipërisë propozohet nga governatori dhe emërohet nga Presidenti i Republikës.

c) Zëvendësgovernatori i Bankës së Shqipërisë propozohet nga governatori dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

d) Një anëtar propozohet nga ministri i Financave dhe miratohet nga Kuvendi Popullor.

e) Një anëtar propozohet nga governatori dhe miratohet nga Kuvendi Popullor.

f) Një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës dhe miratohen nga Kuvendi Popullor.

g) Një anëtar propozohet nga Këshilli i Ministrave dhe miratohet nga Kuvendi Popullor.

3. Governatori dhe zëvendësgovernatori nuk janë drejtorë të departamenteve dhe nuk kryejnë funksione të tjera operative në Bankën e Shqipërisë.

4. Kandidatët për anëtarë të këshillit mbikëqyrës duhet të jenë shtetas shqiptarë, persona që gëzojnë reputacion të mirë, zotërojnë gradë universitare dhe kanë përvojë profesionale në çështje monetare e bankare, ndaj të cilëve nuk mund të gjenden arsye për t'i hequr sipas nenit 49.

5. Afati për çdo anëtar të këshillit mbikëqyrës është shtatë vjet, me kusht që datat e përfundimit të afatit të anëtarëve të veçantë të këshillit të shpërndahen mundësisht në mënyrë të barabartë gjatë periudhës shtatëvjeçare. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të rizgjidhen, përveçse kur shkarkohen sipas rasteve të parashikuara në nenin 49.

Neni 43
Përgjegjësitë e governatorit

1. Governatori i Bankës së Shqipërisë është edhe Drejtor Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë. Në rast se governatori mungon ose është në pamundësi për të vepruar, Zëvendësgovernatori i parë vepron

si Drejtor Ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë përgjatë periudhës së mungesës ose pamundësisë. Në rast se zëvendësgovernatori i parë gjithashtu mungon ose është në pamundësi për të vepruar, zëvendësgovernatori vepron si drejtor ekzekutiv i Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

2. Governatori përgjigjet për hartimin e zbatimin e politikës monetare, politikës të këmbimeve valutore dhe politikave të tjera, për paraqitjen e tyre në këshill dhe për zbatimin e vendimeve të tij. Ai përfaqëson Bankën e Shqipërisë në marrëdhënie me subjekte të huaja. Zëvendësgovernatori i parë përgjigjet për mbikëqyrjen e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë.

3. Të gjitha kompetencat që nuk specifikohen për këshillin mbikëqyrës i njihen governatorit ose, në rastin kur governatori mungon, ose është në pamundësi për të vepruar, këto kompetenca i njihen zëvendësgovernatorit të parë të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet kontraktuese në emër të Bankës së Shqipërisë dhe përfaqësimin e saj në procedurat ligjore. Governator mund t'ua delegojë didsa nga kompetencat e tij nëpunësve të Bankës së Shqipërisë.

Neni 44
Funksionet e këshillit mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës ngarkohet për miratimin dhe përshtatjen e politikave për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe për mbikëqyrjen e realizimin e tyre.

2. Në përmbushjen e funksioneve të tij, këshilli mbikëqyrës duhet të bëjë periodikisht vlerësimin e gjendjes ekonomike e monetare të Republikës së Shqipërisë. Për këtë zëvendëskryetari i këshillit përgjigjet për paraqitjen e raporteve të strukturave të Bankës së Shqipërisë në këshillin mbikëqyrës jo më pak se një herë në dy muaj për:

a) administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë;

b) ecurinë e politikës së saj monetare dhe rregulluese;

c) qëndrueshmërinë e sistemit financiar, duke përfshirë sidomos sistemin bankar;

d) gjendjen e parasë, tregun e kapitaleve dhe këmbimeve valutore, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet që kanë ose pritet të kenë efekt të rëndësishëm në operacionet e Bankës së Shqipërisë, ose mbi ecurinë e politikave të kësaj të fundit, si dhe mbi sistemin financiar a mbi tregjet e lartpërmendura.

Neni 45
Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës ka këto kompetenca:

a) Të miratojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë të paraqitur nga governatori, duke dhënë orientimet për operacionet e hapura në treg nga Banka e Shqipërisë, përqindjen e interesave për depozitat dhe miratimin e kredive nga Banka e Shqipërisë, si dhe llojet e nivelet e rezervave të detyrueshme që bankat duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë.

b) Të miratojë politikën e këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë të paraqitur nga governatori dhe të vendosë rregulla për përcaktimin e vlerës së lekut në raport me valutat e huaja.

c) Të miratojë të gjitha rregulloret, urdhrat dhe udhëzimet me zbatim të përgjithshëm, që nxirren në Bankën e Shqipërisë.

d) Të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit Popullor ose Këshillit të Ministrave.

e) Të vendosë për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.

f) Të përcaktojë vlerën nominale, prerjet dhe konfigurimin e kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe kushtet e tërheqjes nga qarkullimi.

g) Të miratojë linjat orientuese për dhënien e kredisë nga Banka e Shqipërisë për qeverinë, parashikuar sipas dispozitave të kapitullit V të këtij ligji.

h) Të miratojë, me pëlqimin e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit Mbikëqyrës, çdo dhënie kredie nga Banka e Shqipërisë, ose të huave të kushtëzuara në përfitim të një banke, në përputhje me nenin 20/2.

i) Të miratojë "Statutin e Bankës së Shqipërisë" dhe të përcaktojë politikat për administrimin dhe operacionet e saj.

j) Të përcaktojë strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë.

k) Të përcaktojë në përgjithësi kushtet e marrjes në punë e të emërimit të punonjësve në Bankën e Shqipërisë, agjentëve dhe bankave korrespondente të Bankës së Shqipërisë.

l) Të krijojë dhe të mbyllë filiale, degë ose agjenci të Bankës së Shqipërisë.

m) Të përcaktojë buxhetin vjetor të Bankës së Shqipërisë.

n) Të propozojë rritje të kapitalit të Bankës së Shqipërisë dhe të vendosë për fondin rezervë të Bankës së Shqipërisë.

o) Të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të Bankës së Shqipërisë.

p) Të përcaktojë letrat me vlerë të borxhit që do të shikohen si instrumente të përshtatshme për investime nga Banka e Shqipërisë.

q) Të përcaktojë udhëzuesin për emetimin e letrave me vlerë të borxhit nga Banka e Shqipërisë.

B. KOMITETI DREJTUES

Neni 46

1. Komiteti drejtues zbaton politikat e miratuara nga këshilli mbikëqyrës për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

2. Komiteti drejtues përbëhet nga governatori, zëvendësgovernatori i parë, zëvendësgovernatori dhe drejtorët e departamentit të Bankës së Shqipërisë.

3. Drejtorët e departamenteve emërohen nga governatori i Bankës së Shqipërisë.

4. "Statuti" i Bankës së Shqipërisë rregullon procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të komitetit drejtues.

Neni 47
Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe personelit

Këshilli mbikëqyrës vendos për shpërblimin e anëtarëve të këshillit dhe të personelit të Bankës së Shqipërisë. Shuma totale e shpërblimit përcaktohet duke përfshirë shpërblimin e punës, si dhe kompensimet dhe vlerën e ndonjë kompensimi jo monetar, përfshirë shëndetin, kalimin e kohës së lirë ose përfitime për banesë.

Neni 48
Pamundësia për anëtarësi në këshillin mbikëqyrës

Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës ndërkohë që ai ose ajo mund të jenë deputetë në Kuvendin Popullor apo anëtarë të Këshillit të Ministrave.

Neni 49
Shkarkimi dhe lëvizja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

1. Governatori dhe anëtarët e tjerë të këshillit mbikëqyrës pezullohen nga detyra deri në miratimin nga organet e emërtesës, prej këshillit mbikëqyrës në qoftë se ata:

a) janë në pamundësi për të shërbyer në këshillin mbikëqyrës sipas neneve 42 ose 58/1;

b) janë dënuar për vepër penale;

c) janë në vështirësi financiare ose janë deklaruar të falimentuar dhe nuk kanë paguar borxhet;

d) gjatë ushtrimit të detyrës janë diskualifikuar ose pezulluar nga organet kompetente.

2. Një a më shumë anëtarë të këshillit do të largohen nga detyra prej këshillit mbikëqyrës kur:

a) personi i propozuar për largim ka munguar për tri ose më shumë herë radhazi në mbledhjet e radhës të këshillit, pa shkak të arsyeshëm;

b) personi i propozuar për largim është në pamundësi fizike a mendore për të mbuluar funksionet e ngarkuara; ose

c) personi i propozuar për largim gjatë ushtrimit të detyrës ka kryer kundërvajtje, që ka cenuar thellë interesat e Bankës së Shqipërisë.

3. Asnjë anëtar i këshillit nuk mund të largohet nga detyra për shkaqe ose procedura të tjera.

Neni 50
Dorëheqja nga anëtarësia në këshill

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim këshillin mbikëqyrës jo më pak se tre muaj nga data e njoftimit.

Neni 51
Vendet vakante në këshillin mbikëqyrës

Çdo vend vakant në këshillin mbikëqyrës plotësohet me emërimin e anëtarit të ri të këshillit mbikëqyrës, në përputhje me nenin 42, për të vepruar për kohën e mbetur të anëtarit të zëvendësuar të këshillit, në qoftë se është për më shumë se dy vjet, ose shtatë vjet.

Neni 52
Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës

1. Governatori ose në mungesë të tij a në pamundësi të votojë, zëvendësgovernatori i parë, duhet të kryesojë mbledhjet e këshillit mbikëqyrës.

2. Këshilli mbikëqyrës mblidhet sa herë që kërkohet për realizimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë, por jo më pak se një herë në çdo muaj kalendarik.

3. Normalisht mbledhjet e këshillit mbikëqyrës thirren nga governatori. Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës mund të thirren edhe me kërkesë me shkrim nga çdo tre prej anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

4. Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës thirren duke komunikuar kohën, vendin dhe programin e mbledhjes për gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës brenda pesë ditëve pune përpara datës së caktuar për mbledhje, përveç rasteve kur ka urgjencë dhe mbledhjet e këshillit mbikëqyrës mblidhen me afat njoftimi më të shkurtër.

5. Çdo anëtar i këshillit mbikëqyrës ka të drejtën e një vote. Pjesëmarrja për çdo mbledhje të këshillit mbikëqyrës plotësohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të emëruar, duke përfshirë praninë e governatorit ose të zëvendësgovernatorit të parë.

6. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, vendimet e këshillit mbikëqyrës miratohen me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të këshillit, të cilët janë të pranishëm në mbledhje. Vetëm anëtarët e këshillit që janë personalisht të pranishëm kanë të drejtën e votës; sidoqoftë "Statuti i Bankës së Shqipërisë" mund të lejojë mbledhjet e këshillit dhe votimin me mjete të tjera komunikimi, me kusht që këto të fundit të lënë gjurmë, për të pasqyruar vullnetin e votuesit për mënyrën e kalimit të çështjes në fjalë. Në rast barazie vote, kryetari i mbledhjes ka votën përcaktuese.

7. Duke pasur parasysh pikën 5 të këtij neni, lidhur me pjesëmarrjen, asnjë veprim ose procedurë e këshillit nuk do të konsiderohet e pavlefshme thjesht për shkak të qenies së vendit vakant, ose të vendeve vakante të këshillit.

8. Të gjitha veprimet e kryera në mirëbesim nga një person me cilësinë e kryetarit ose të anëtarit të këshillit mbikëqyrës do të jenë të vlefshme, pavarësisht nga disa mangësi që janë zbuluar në emërimin, rregullsinë a në kualifikimin e tij.

Neni 53
Procedurat e mbledhjes dhe vendimet e këshillit mbikëqyrës

1. Procedurat dhe rezultatet e mbledhjes së këshillit janë konfidenciale. Këshilli mbikëqyrës mund të vendosë për të bërë të njohura një pjesë ose të gjitha vendimet e tij.

2. Protokolli i mbledhjes për çdo mbledhje të këshillit mbikëqyrës firmoset nga kryetari dhe sekretari ose zëvendëssekretari i këshillit.

3. Sekretari i këshillit është përgjegjësi i sektorit të shërbimit juridik, kurse zëvendëssekretari emërohet nga kryetari i këshillit prej personelit të Bankës së Shqipërisë, ata nuk janë anëtarë të këshillit.

4. Vendimet e këshillit regjistrohen dhe nxirren me nënshkrimin e anëtarit që drejton

mbledhjen e këshillit që ka miratuar vendimin, si dhe të sekretarit të këshillit mbikëqyrës.

Neni 54
Deklarata e anëtarëve të këshillit

1. Që në momentin e pjesëmarrjes në këshill dhe për çdo vit e më pas, anëtarët e këshillit dhe të komitetit drejtues do të deklarojnë pranë këshillit mbikëqyrës plotësisht interesat e tyre thelbësore që ata ose anëtarët e tjerë të familjes mund të kenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, këto deklarata duhet të bëhen sipas orientimeve të miratuara nga këshilli mbikëqyrës.

2. Kurdoherë që shtrohen për diskutim në këshill çështje në lidhje me këta interesa, anëtari që ka lidhje me çështjen duhet të deklarojë interesat e tij ose të saj në fillimin e diskutimit dhe nuk do të marrë pjesë në diskutimin dhe vendimin mbi këtë çështje; megjithatë prania e tij do të llogaritet për efekt të pjesëmarrjes sipas nenit 52, pika 5.

Neni 55
Departamenti i kontrollit dhe inspektori i përgjithshëm

1. Banka e Shqipërisë do të ketë një departament kontrolli të përbërë nga persona të kualifikuar e të specializuar për kontabilitetin dhe drejtimin financiar, detyra e të cilëve është kryerja e kontrolleve të brendshme financiare e operacionale të bankës, organizimi i kontrolleve të brendshme tematike dhe përgatitja e raporteve periodike, siç është përshkruar në pikën 4.

2. Inspektori i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë emërohet për një afat pesëvjeçar nga këshilli mbikëqyrës, midis kandidatëve që janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe ndaj të cilëve nuk vërtetohen rastet e parashikuara në nenin 49. Ai ose ajo mund të riemërohen. Paga e tij ose e saj dhe shpërblimet përcaktohen nga këshilli mbikëqyrës.

3. Inspektori i përgjithshëm mund të japë dorëheqjen tre muaj pas njoftimit te governatori. Inspektori i përgjithshëm largohet vetëm me vendim të këshillit mbikëqyrës, kur vërtetohen një ose disa nga shkaqet e përshkruara në nenin 49.

4. Inspektori i përgjithshëm drejton departamentin e kontrollit të Bankës së Shqipërisë. Inspektori i përgjithshëm dhe inspektorët e departamentit të kontrollit kanë për detyrë:

a) të organizojnë dhe të kryejnë kontrolle të brendshme për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe të kryejnë kontrolle të brendshme periodike për administrimin dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë, me qëllim që të sigurojnë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të Bankës së Shqipërisë;

b) të kontrollojnë dhe t'i paraqesin këshillit mbikëqyrës raporte e rekomandime për llogaritë dhe regjistrat, si dhe për procedurat buxhetore, kontabël dhe kontrollet e Bankës së Shqipërisë;

c) të kontrollojnë raportet periodike financiare dhe dokumentet e lidhura me to të Bankës së Shqipërisë dhe, në qoftë se janë përgatitur në mënyrën e duhur, të nxjerrin certifikatë për këtë qëllim.

Neni 56
Personeli i Bankës së Shqipërisë

1. Gjatë punësimit në Bankën e Shqipërisë, personeli i saj nuk mund të punësohet nga ndonjë subjekt tjetër, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë vendos ndryshe.

2. Banka e Shqipërisë mund të vendosë kufizime për marrjen e kredive prej institucioneve financiare nga personeli i Bankës së Shqipërisë.

3. Këshilli mbikëqyrës miraton rregulloren e personelit që trajton kushtet e punësimit në Bankën e Shqipërisë.

Neni 57
Nëpunësit, agjentët dhe bankat korrespondente të Bankës së Shqipërisë

1. Governatori emëron dhe largon nëpunësit, agjentët dhe bankat korrespondente të Bankës së Shqipërisë, sipas dhe brenda kufijve, në përputhje me kushtet e afatet e përgjithshme të punësimit dhe emërimeve të parashikuara nga këshilli mbikëqyrës dhe të pasqyruara në kontratën kolektive e

individuale të punës.

2. Asnjë pagë, shpërblim, kuotë, ose e ardhur tjetër, apo paradhënie e paguar nga Banka e Shqipërisë nuk do të llogaritet mbi bazën e të ardhurave neto, fitimit neto ose të të ardhurave të tjera të Bankës së Shqipërisë.

Neni 58
Konfliktet mbi interesat

1. Gjatë veprimtarisë së tyre governatori, zëvendësgovernatori, anëtarët e komitetit drejtues dhe inspektori i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë ia përkushtojnë të gjitha aftësitë e tyre profesionale shërbimit në Bankën e Shqipërisë dhe asnjë nga ata nuk mund të merret me punë të tjera a të punësohet, me shpërblim ose jo, përveç rasteve kur caktohen nga Banka e Shqipërisë.

2. Asnjë punonjës i Bankës së Shqipërisë nuk mund të merret njëkohësisht me një punë tjetër, pavarësisht me shpërblimin ose jo, pa miratim paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

3. Asnjë anëtar i këshillit mbikëqyrës ose punonjës i Bankës së Shqipërisë nuk duhet të veprojë si përfaqësues i veprimtarive tregtare, financiare a të veprimtarive të tjera tregtare, ose të vendosë vetveten në një pozitë të tillë që bie ndesh me detyrat e tij në Bankën e Shqipërisë.

4. Asnjë anëtar i këshillit mbikëqyrës ose punonjës nuk duhet të pranojë ndonjë dhuratë a kredi për veten e tij, ose në emër të çdo personi me të cilin ai ka lidhje familjare, veprimtari tregtare a financiare, në qoftë se pranimi në këtë rast mund të rezultojë me uljen e përkushtimit të nevojshëm ndaj detyrave të tij në Bankën e Shqipërisë.

Neni 59
Sekreti

1. Asnjë person që shërben ose ka shërbyer si anëtar i këshillit mbikëqyrës a punonjës i Bankës së Shqipërisë, si inspektor kontrolli ose si agjent i Bankës së Shqipërisë, nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj:

a) të lejojë zbulimin ose publikimin e informacioneve jopublike, të cilat ai ose ajo i ka përfituar nga kryerja e detyrave të tij ose të saj; ose

b) të përdorë këtë informacion, apo të lejojë që ky informacion të përdoret për përfitime personale.

2. Këta persona mund të bëjnë të njohur informacionin jopublik jashtë Bankës së Shqipërisë, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, vetëm kur:

a) jepet pëlqimi i shprehur ose i nënkuptuar i personit që është përgjegjës për këtë informacion;

b) kryhet detyrimi ndaj publikut për të bërë të njohur një informacion, duke përfshirë urdhrin e gjykatës ose të një personi tjetër që përfaqëson një organ kompetent;

c) kërkohet nga kontrollorët e jashtëm të Bankës së Shqipërisë;

d) kërkohet nga autoritetet mbikëqyrëse të institucioneve të huaja financiare; ose

e) interesi i vetë Bankës së Shqipërisë në procedurat ligjore e kërkon dhënien e informacionit.

KREU VIII
DREJTIMI I KËMBIMEVE VALUTORE, OPERACIONET E KËMBIMEVE VALUTORE, REZERVA VALUTORE DHE LLOGARITË REZERVË TË VEÇANTA

Neni 60

1. Politika e këmbimeve valutore përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, e cila e zbaton atë në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore.

2. Banka e Shqipërisë vepron si agjent jo ekskluziv për shtetin për administrimin sipas ligjit në fuqi lidhur me kontrollin e këmbimeve valutore.

3. Raportet, deklaratat, llogaritë dhe informacionet e kërkuara nga dispozitat e këtij ligji, mund të shpërndahen nëpërmjet Bankës së Shqipërisë.

Neni 61

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të:

a) nxjerrë rregullore dhe udhëzime që rregullojnë transaksionet e këmbimeve valutore të individëve, të subjekteve jofinanciare, të institucioneve financiare dhe njësive e agjencive qeveritare;

b) licencojë, të revokojë licencën, të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat;

c) vendosë limite mbi pozicionet e këmbimeve valutore të agjentëve të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat;

d) vendosë për metodat e përcaktimit të vlerës së Lekut në raport me monedhat e tjera;

e) mbajë e administrojë rezervën valutore ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 62

Agjentët e licencuar të këmbimeve valutore, duke përfshirë bankat, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, duhet të raportojnë periodikisht pranë Bankës së Shqipërisë për operacionet e tyre, duke përfshirë pozicionet e hapura të këmbimeve valutore sipas monedhave. Banka e Shqipërisë duhet të përcaktojë formën e raportimit dhe dokumentet shoqëruese që duhet të dorëzohen.

Neni 63

Banka e Shqipërisë mundet që, si për llogari të saj, ashtu dhe për llogari dhe me urdhër të shtetit, të marrë pjesë në marrëveshjet e kleringut dhe të pagesave ose në ndonjë kontratë tjetër për të njëjtin qëllim me institucionet publike a private qendrore të kleringut, të vendosura jashtë shtetit.

Neni 64

Banka e Shqiprisë ka të drejtë:

a) të blejë, shesë a tregtojë ar në monedhë ose lingotë, apo metale të tjera të çmuara.

b) të blejë, shesë a tregtojë valutë, duke përdorur për këtë qëllim mjetet e veta, sipas nenit 65;

c) të blejë dhe të shesë bono të thesarit dhe letra me vlerë të emetuara ose të garantuara nga qeveritë e huaja dhe nga institucionet financiare publike ndërkombëtare;

d) të vendosë kurset, me të cilat mund të blejë, shesë a tregtojë monedha të huaja.

Neni 65

1. Banka e Shqipërisë mban në bilancin e saj dhe administron rezervën valutore ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, e cila konsiston në të gjitha ose në një pjesë të mjeteve të mëposhtme:

a) ar;

b) valutë në formën e kartëmonedhës dhe monedhës ose në llogaritë e Bankës të mbajtura jashtë shtetit në monedhë të huaj;

c) çdo mjet tjetër ndërkombëtar të njohur, duke përfshirë:

i) të drejtën për blerjen e transheve të rezervës nga Fondi Monetar Ndërkombëtar;

ii) mbajtjen nga shteti të monedhës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (S.D.R.);

d) kambialet dhe premtimet e pagesës, të pagueshme në valutë;

e) letra me vlerë të borxhit të emetuara ose të garantuara nga blerje me afat ose në marrëveshje me kusht riblerjeje të përfunduara me ose të garantuara nga shtete të huaja ose banka qendrore, ose nga organizata financiare ndërkombëtare publike, të nominuara dhe paguara në monedhë të huaj.

2. Objektivi primar i kompozimit të mjeteve rezervë do të jetë siguria e tyre dhe likuiditeti.

3. Banka e Shqipërisë do të përdorë mundësitë e saj më të mira për të mbajtur rezervën valutore ndërkombëtare në një nivel që sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë do të jetë i përshtatshëm për zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore të Republikës së Shqipërisë dhe për ekzekutimet e menjëhershme të pagesave në transaksionet me jashtë.

4. Në rast se rezerva valutore e lartpërmendur zvogëlohet ose, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, është në rrezik të zvogëlimit në ato përmasa sa të rrezikojë zbatimin e politikës monetare dhe të këmbimeve valutore, apo ekzekutimet e menjëhershme të pagesave në transaksionet me jashtë, Banka e Shqipërisë i dorëzon Këshillit të Ministrave një raport për pozicionet e rezervës valutore ndërkombëtare dhe shkaqet që kanë çuar ose mund të çojnë në një rënie të tillë, së bashku me rekomandimet përkatëse për rregullimin e situatës.

5. Deri për sa kohë që, sipas opinionit të saj, situata nuk është rregulluar, Banka e Shqipërisë do të bëjë raporte të mëtejshme dhe rekomandime që do të konsiderohen si të këshillueshme.

Neni 66

Banka e Shqipërisë hap një llogari për vlerësimin e rezervës në librat e saj. Në këtë llogari do të regjistrohen të gjitha fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga vlerësimi i aktiveve në valutë.

Humbjet që rrjedhin nga vlerësimi dhe nuk mbulohen nga kjo balancë, do të mbulohen në përputhje me nenin 9/c të këtij ligji, si dhe fitimet e vlerësuara nuk mund të futen në fitimet e Bankës së Shqipërisë dhe nuk mund të transferohen në buxhet.

KREU IX
FUQIA E AKTEVE

Neni 67

1. Banka e Shqipërisë nxjerr rregullore, urdhra dhe udhëzime për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

2. Të gjitha rregulloret dhe rekomandimet e nxjerra nga Banka e Shqipërisë dhe që zbatohen nga disa institucione, publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe hyjnë në fuqi në datën e publikimit ose në një datë të mëvonshme të parashikuar nga Fletorja Zyrtare. Banka e Shqipërisë mban regjistrin publik të rregulloreve dhe rekomandimeve.

Neni 68

1. Banka e Shqipërisë përdor të drejtat e saj të parashikuara në këtë ligj në mënyrë të paanshme e uniforme dhe në përputhje me praktikat e njohura administrative.

2. Vendimet e Bankës së Shqipërisë të marra në përputhje me këtë ligj janë objektive dhe motivohen vetëm për qëllime objektive e racionale; ato zbatohen të kontrolluara dhe në mënyrë të përpiktë.

3. Kurdoherë, kur janë përdorur në këtë ligj, termat e mëposhtme nënkuptojnë:

a) “Bankë” nënkupton një institucion financiar nën çdo lloj emri të njohur që pranon depozita, jep kredi, paguan çeqe dhe kryen shërbimet që lidhen me veprimtaritë përkatëse për publikun.

b) “Institucion financiar” nënkupton një person juridik a fizik i angazhuar në veprimtari të marrjes së depozitave nga publiku në vend dhe përdorimin e fondeve të tilla tërësisht a pjesërisht për dhënie kredie ose bërje investimesh për llogari të personit që kryen veprimtari tregtare, i cili mbart edhe rrezikun.

c) “Letra me vlerë të detyrimeve” nënkupton instrumentet e bisedimit të detyrimeve dhe çdo instrument tjetër të barasvlefshëm me këto instrumente të detyrimeve, pavarësisht nëse janë të formës fizike (me certifikatë) ose të formës së regjistruar (book-entry);

d) “Letrat me vlerë të qeverisë” nënkuptojnë letrat me vlerë të detyrimeve që janë emetuar nga Republika e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financës, duke përfshirë edhe bonot e thesarit;

e) “Urdhër” nënkupton një direktivë detyruese për zbatimin e ligjit ose për rregulloret e nxjerra në zbatim të ligjit të nxjerrë për një ose disa institucione financiare që përbëjnë një ose më shumë grupe të institucioneve financiare ose të personave fizikë a juridikë;

f) “Rregullore” nënkupton një direktivë detyruese të përgjithshme për zbatimin e këtij ligji të nxjerrë për një ose disa grupe të institucioneve financiare ose të personave fizikë a juridikë;

g) “Shteti” nënkupton gjithnjë Republikën e Shqipërisë.

KREU X
KONTABILITETI DHE BILANCI I BANKËS

Neni 69

Viti financiar i Bankës së Shqipërisë fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 70

Banka e Shqipërisë mban, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe standartet ndërkombëtare, llogari e regjistra, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 71

Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë kontrollohen çdo vit nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga këshilli mbikëqyrës. Kontrollorët që do të shprehin opinionet e tyre, nëse raportet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë paraqesin në mënyrë të plotë dhe të drejtë situatën financiare të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të pranuara përgjithësisht të kontabilitetit.

Neni 72

1. Banka e Shqipërisë përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar. Ato i paraqiten Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave nga governatori i Bankës së Shqipërisë jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të vitit financiar të Bankës.

2. Raporti dhe bilanci financiar i Bankës së Shqipërisë shpallen në formën e përcaktuar nga Banka, pas miratimit të tyre nga këshilli mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

3. Raporti duhet të përfshijë edhe opinionin e kontrollorëve lidhur me gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë publikon çdo muaj përmbledhjen e bilancit të saj.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 73

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dokumente ose informacione të tjera lidhur me marrëdhëniet ndërmjet secilës prej tyre dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 74

Asnjë person që është anëtar i këshillit mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë ose nëpunës, gjatë dhe pas largimit nga detyra, nuk lejohet të bëjë të njohur ose të publikojë, ndryshe nga ç'parashikon ky ligj, informacione dhe materiale jopublike, me të cilat është e njohur gjatë kohës së kryerjes së detyrës, që kanë të bëjnë me veprime bankare, vlera ose burime të ardhurash, fitime, humbje a shpenzime të Bankës së Shqipërisë. Asnjë person nuk lejohet të përdorë informata të tilla për përfitime peronale, ose t'ua japë personave të paautorizuar. Për shkelje të kësaj dispozite personat mbajnë përgjegjësi sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 75

Çdo person juridik a fizik, i cenuar nga shkeljet e pretenduara të këtij ligji, nga ana e Bankës

së Shqipërisë, mund t‘i kundërshtojë ato përpara Gjykatës së Apelit.

Konflikti në diskutim i Bankës së Shqipërisë do të zbatohet pa kufizim, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Vendimi i gjykatës do të konsistojë vetëm nëse veprimi i Bankës së Shqipërisë është në përputhje ose jo me ligjin.

Neni 76

Banka e Shqipërisë përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat.

Kartëmonedhat që qarkullojnë me emrin “Banka e Shtetit Shqiptar”, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme pa kufizim.

Kartëmonedhat e reja do të emetohen me emrin “Banka e Shqipërisë”.

Neni 77

Banka e Shqipërisë ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 78

Ligji nr.7559, datë 22.4.1992 “Për Bankën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 79

Ky ligj hyn në fuqi më 1 mars 1996.

Shpallur me dekretin nr.1405, datë 11.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Sali Berisha